



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POSTA SHQIPTARE SH.A

Tiranë, më 03.06.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Toner”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
30125110-5 - Toner per printer lazer /makina fax.

VLERA E FONDIT LIMIT: 30,716,086 (tridhjetë milion e shtatëqind gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në Eur: 313,493.43 (treqind e trembëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tre pikë dyzet e tre) Euro pa tvsh. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 03.06.2025 është 97.98 Lekë/Euro.

I .ARGUMENTIMI I MOS NDARJES NË LOTE

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020,i ndryshuar të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “Posta Shqiptare” SH.A. ka vendosur që kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyesimit te meposhtem:

Objekti i prokurimit është konceptuar si një i tërë dhe për këtë arsye është e pamundur të ndahet në lote.

Përsa më lart ndarja në lote do ta ndërlikonte dhe vështirësonte procesin e zbatimit të kontratës duke krijuar vonesa dhe rrjedhimisht do sillte problematika për blerjen e mallit tonera.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të cilët kanë njohuri të posacme për objektin e prokurimit.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e

ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

III. ARGUMENTIMI VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, **Autoriteti ynë kontraktor**, ka zbatuar parashikimet e Nenit 76 të VKM nr.285 pika 1 b duke marrë oferta nga operatorët ekonomik të fushës. Ofertat janë administruar në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit dhe janë pjesë e dosjes.

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

AFATI I OFRIMIT TË SHËRBIMIT: Malli objekt kontrate do të lëvrohet me dërgesa të pjesshme sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, për gjatë periudhës 6 (gjashtë) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **SH.A. Posta Shqiptare**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; në vlerën 614,321.74 (gjashtëqind e katërmëdhjet mijë e treqind e njëzet e një pikë shtatëdhjetë e katër) lekë, në euro **6,269.869 (gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) euro.**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar)

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit.....

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 95% e vlerës së fondit limit..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 39 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kerkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OSE

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që mallrave të furnizuara të mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për mallrat të furnizuara të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent** (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues që Operatori Ekonomik të jetë i pajisur dhe të paraqesë në sistemin elektronik të prokurimit Standardin ISO 9001:2015 për menaxhimin e cilësisë, pasi ky standard garanton që operatori ka një sistem të strukturuar dhe të certifikuar për menaxhimin efektiv të proceseve dhe cilësisë së shërbimeve që ofron. Ky kriter është thelbësor për të siguruar që produktet dhe shërbimet që ofrohen janë në përputhje me kërkesat e prokurimit kombëtar dhe standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, një certifikim i tillë i lëshuar nga një organ i akredituar ofron garanci për cilësinë dhe besueshmërinë e operatorit, duke minimizuar rrezikun e dështimeve dhe sigurimin e një vazhdimësie të qëndrueshme në projekt. Standardi ISO 9001:2015 promovon përmirësim të vazhdueshëm dhe është i njohur ndërkombëtarisht, duke rritur transparencën dhe sigurinë për përputhshmërinë e ofrimit të shërbimeve me nevojat dhe pritshmëritë e Autoritetit Kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik të paraqesë një Deklaratë e cila të përmbajë:

- a) Cilësinë dhe origjinën e mallrave, objekt i këtij prokurimi.
- b) Në momentin e dorëzimit të mallit tek autoriteti kontraktor, malli do të shoqërohet me certifikatën e cilësisë dhe origjinën e tij.
- c) Tonerat do të jenë bojra origjinale ose ekuivalente , me vulë origjinaliteti, të pahapura dhe jo të rimbushura, të shoqëruara me pulle sigurie nga prodhuesi, kur aplikohet nga prodhuesi.
- d) Tonerat duhet të jenë në konformitet të plotë me standartin e kërkuar sipas tipit të printerit ose fotokopjes dhe të funksionojnë në paisje..
- e) Çdo lloj boje që do të rezultojë jashtë kushteve të kërkuara ose do të paraqesë probleme gjatë përdorimit do të kthehet shitësit.
- f) Tonerat duhet të kenë garanci jo më të vogël se 2 vite.

Argumentim: Në bazë të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se artikujt objekt prokurimi janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.4 Emri i kompanisë prodhuese të tonerave duhet të jetë i stampuar dhe i njejtë në paketim, cartridge(toner) dhe të ketë pullën e sigurisë, në rast kur aplikohet nga prodhuesi numrat serial të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjithë pjesët përbërëse të trupit të toner dhe të jenë të verifikueshëm në faqet zyrtare te prodhuesve në internet.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të permbushin kerkesat me qëllim krijimin e sigurisë dhe garancisë për Autoritetin Kontraktor që malli me të cilin do furnizohet ky i fundit, ti përshtatet llojeve dhe pajisjeve të printimit dhe fotokopjimit.

2.3.5 Operatori ekonomik për të vërtetuar se tonerat që oferton në këtë procedurë do të jenë tonera origjinale ose ekuivalente tëfirmave prodhuese, duhet të japë nformacionin e kërkuar në tabelën e mëposhtme:

Te dhena mbi kompanine nga I cili operatori ekonomik do te furnizohet				
Nr.	Tonerat sipas markes se printerit/fotokopjes(original/ekuivalent)	Emri i kompanise furnizuese	Adrese interneti	Kontakt(email/nr tel)
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë këtë fakt me qëllim krijimin e sigurisë dhe garancisë për Autoritetin Kontraktor që malli me të cilin do furnizohet ky i fundit, ti përshtatet llojeve dhe pajisjeve të printimit dhe fotokopjimit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë, në datën dhe orën e hapjes së tenderit, mostrën për të 14 artikujt sipas renditjes në shtojcën nr. 7 “Formulari i Sasië dhe Grafikut të Lëvrimit”

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: Mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE).
- Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”
- Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/a nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se tonerat të jenë sipas kërkesave dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

Sqarim! Të gjitha kriteret e sipërcituara në **Shtojca 8, të DST-së**, të cilat përfshihen në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojca 9, të DST-së, do të vlerësohen të përmbushura në fazën e vlerësimit të ofertave të ofertuara në SPE.*”

Referuar përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, si dhe përcaktimet e pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin...”, Ofertuesi fitues, përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.

NJËSIA E PROKURIMIT